



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQSOR
VLORE

Nr. 593 (117) Akti

Nr. 117 Vendimi

V E N D I M

“NË EMËR TË REPUBLIKËS“

Gjykata e Rrethit Gjyqsor Vlorë, e përbërë nga:

ELVANA ÇIÇOLLI - GJYQTARE

si bashkëpunuese prej sekretares gjyqësore Marjancla Beshtika, sot më datë 03.05.2010, mori në shqyrtimit në seancë publike, kërkesën penale nr. 593 të gjyqësorit i përket:

Kërkesues :

[Redacted] i biri i Servetit i datëlindjes [Redacted] lindur dhe [Redacted] banues në Sarandë, përfaqësuar nga A [Redacted] dhe A [Redacted]

si pjesëmarrjen e Prokurorisë së Rrethit Gjyqsor Vlorë përfaqësuar nga prokurori [Redacted]

Objekti :

Kundërshtim i sekuestros vendosur mbi pronat e mia me shkresën nr 3304 datë 05.05.2009 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqsor Vlorë.

Baza ligjore :

Neni 212 i K.pr.penale

Gjykata në përfundim të shqyrtimit gjyqsor pasi dëgjoi konkluzionet e bashkëpunuesve ku u kërkuar:

- Nga ana e kërkesit :
- Pranimi I kërkesës
- Nga ana e Prokurorisë së Rrethit Gjyqsor Vlorë:
- Mospranimi I kërkesës

VËREN

Se nga ana e kërkuessit është paraqitur përpara Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë kërkesa për "Kundërshtimin e sekustros të vendosur me shikresën nr 3304 datë 05.05.2009 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë".

Kërkuessi [redacted] nëpërmjet kësaj kërkesë pretendon kundërshtimin e shkresës me nr 3304 prot datë 05.05.2009 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë me anë të të cilës është njoftuar ZRPP Sarandë për bllokimin e e transaksioneve për subjektin [redacted] si dhe bashëgimtarët e tjerë të subjekteve të [redacted] dhe [redacted]

kye shkresë është ndërmarrë nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë në ndërr të procedimi penale në ngarkim të [redacted] i cili dyshohet për kryerjen e veprës penale të "Falsifikimit të dokumentave".

Përpara fillimit të shqyrtimit gjyqësor nga ana e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë u pretenduar mungesa e kompetencës së gjykatës për të shqyrtuar këtë kërkesë pasi nga një gjyqtare tjetër e po kësaj gjykate ka filluar shqyrtimi gjyqësor për çështjen penale në ngarkim të të pandehurit [redacted] në dosjen e themelit ndodhet dhe shkresa e kundërshtuar nga ana e kërkuessit [redacted].

Kërkuessi kundërshtoi këtë pretendim të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë duke parashtruar se kjo kërkesë është paraqitur për gjykim nga Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë përpara se të paraqitej kërkesa për gjykimin e akuzës që rëndon në ngarkim të të pandehurit [redacted] dhe [redacted] po shqyrtohet nga një gjyqtar tjetër i po kësaj gjykate.

Për të verifikuar këto pretendime Gjykata kryesisht cmoi të marrë informacion në lidhje me datën e paraqitjes në gjykatë të kësaj kërkesë nga ana e [redacted] dhe datën e paraqitjes së kërkesës për gjykim nga ana e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Nga sekretaria e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë rezultoi se :
"Kërkesa penale me nr 117 akti me ankues [redacted] është rregjistruar në datë 28.12.2009.
Data e rregjistrimit të çështjes penale me nr 220 është 05.01.2010."

Në këto kushte kjo Gjykatë është kompetentë për shqyrtimin e kësaj kërkesë duke qënë se është një kërkesë që i përket fazës së hetimeve paraprake dhe është paraqitur në gjykim përpara se të paraqitej kërkesa për gjykimin e çështjes penale në ngarkim të [redacted]

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, është kompetente për shqyrtimin e kësaj
kërkesë.
Kodi i Procedurës penale parashikon rregullat e përcaktimit të kompetences
të gjykatave. Në asnjë prej dispozitave të K.pr.penale nuk parashikohet dhe
bazohet pretendimi i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë.
është e vërtetë se sipas parimeve të përgjithshme të së drejtës kërkesat
gjyqësore duhet të gjykohen nga gjykata që shqyrton ceshtjen e themelit por
është një parim i cili duhet të ketë në plan të parë respektimin e të
drejtave themelore të njeriut sikurse është e drejta e pronës parashikuar nga
prot 1 të KEDNJ..

Nga pretendimet e palëve dhe provat e paraqitura ka rezultuar se :
Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka filluar procedimin penal në
kërkim të të pandehurit [redacted] dyshuar për kryerjen e veprës penale
"Falsifikimit të dokumentave".
Në kuadër të këtij procedimi Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë i ka
shkresën me nr 3304 prot datë 05.05.2009 ZVRPP Sarandë në të
cilën parashikohet :

*Ne kuadrin e këtij procedimi penal dyshohet se nga ana e antarëve të
Krahut të Gjykatës së Gjyqësore Rajonale të Kthimit dhe Kompesimit të pronave Vlorë , janë kryer
shkelje ligjore në procedurat për njohjen, kthimin dhe kompesimin e
pronës të subjektit [redacted] dhe familjarëve të tij, trashëgimtarë të
shpallur të shpronësuar [redacted]
Shtetasit [redacted] janë përdorur
dokumenta të falsifikuara në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë dhe në
Krahun Rajonale të Kthimit dhe Kompesimit të Pronave Vlorë".*

*Për efekt të mostjetërsimit të pasurive të paluajtshme që dyshohet të
përfutur në kundërshtim me ligjin nga ana e subjekteve të mësipërm ,
Kërkojmë nga ana juaj pezullimin ose ndalimin e kryerjes së cdo veprimi
juridik që ka të bëjë me rregjistrim të pasurisë ose transaksione të tjera
juridike në favor të personave të mësipërm apo personave të tretë.
Kërkojmë nga ana juaj të vendoset ndalimi i transaksioneve mbi këto
prona deri në përfundim të hetimeve për këtë procedim penal..... "*

[redacted] ka marrë dijeni për këtë veprim të Prokurorisë së Rrethit
Gjyqësor Vlorë pas shkresës me datë 22.12.2009 të ZVRPP sarandë
nëpërmjet së cilës njoftohet se :
Ne bazë të shkresës me nr 3304 datë 05.05.2009 të prokurorisë së Rrethit
Gjyqësor Vlorë "për pezullim ose ndalim të kryerjes së cdo veprimi juridik
që ka të bëjë me rregjistrimin e pasurive dhe transaksioneve të tjera
juridike" për subjektin [redacted] dhe familjarët e tij trashëgimtarëve të
subjekteve të shpronësuar [redacted] ju

11
nuk mund të pajiseni me vërtetim pronësie deri në përfundim të hetimeve
për këtë procedim penal.”

Në këto kushte [redacted] ka paraqitur përpara Gjykatës së Rrethit
Gjyqësor Vlorë në datë 28.12.2009 kërkesën penale për kundërshtimin e
sekuestrës së vendosur me shkresën me nr 3304 datë 05.05.2009.

Pretendimet e kërkuësit

1. Prokuroria ka vepruar në kundërshtim me nenin 208 të K.pr.penale pasi ai nuk është shpehur me vendim për sekuestrim por ka dërguar një shkresë ZVRPPP Sarandë me anë të së cilës është bllokuar pronësia.
 2. Në këtë shkresë nga ana e prokurorisë nuk është sqaruar se përse ndalimi itransaksioneve mbi këtë pronë është i domosdoshëm.
 3. Prokuoria nuk më ka njoftuar për këtë veprim. Dijenja ime për këtë shkresë ka ardhur pasi i jam drejtuar ZVRPP Sarandë.
 4. Shkresa e Prokurorisë është në kundërshtim me të gjitha dispozitat që rregullojnë sekuestrimin dhe mjetet e kërimit të provës.
 5. Cënimi i të drejtës së pronësisë mund të kryhet vetëm nga gjykat nëpërmjet një vendimi për sigurim padie dhe jo nëpërmje shkresave të Prokurorisë.
 6. Vendimi i Prokurorit për bllokimin e pasurisë është marrë në një kohë kur emri nuk ishte regjistruar dhe për pasojë nuk ekzistonte cilësia e personit nën hetim.
- G bazë të ktyre pretendimeve kërkuësi ka kërkuar shfuqizimin (revokimin) e sekuestrës te vendosur me shkresen nr 3304 datë 05.05.2009 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Pretendimet e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë

1. Kjo është një praktike e konsoliduar e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë.
2. Nëpërmjet kësaj shkrese thjesht është njoftuar ZVRRP Sarandë për ekzistencën e procedimit. Ky institucion mund të mos e zbatonte këtë shkresë të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë.
3. Kërkesa duhet të rrezohet pasi është pa bazë ligjore, nuk kemi vendim sekuestro në këtë rast.

Arsyetimi Ligjor

Doktrina shqiptare ka sqarur dhe interpretuar kushtet e sekuestros në kuadër të procedimit penal:

Me sekuestrim do të kuptohet:

Kufizimi i perkohshëm, deri në një vendim përfundimtar, i të drejtave pasurore të një personi mbi nje send të caktuar qoftë ky i luajtshem , i paluajtshem apo ndaj një shume të hollash. Ky kufizim i perkohshëm mund te bëhet nëpërmjet marrjes së sendit apo shumës së të hollave, detyrimit per te mos i ushtruar të drejtat, apo nëpërmjet detyrimit të të tretëve te mos i japin mundësi subjektit që të gëzojë sendin.

Në legjislacionin penal Shqiptar jane parashikuar disa lloje sekuestrimesh :

- **Sekuestrimi për qëllime prove**, pra si mjet i kërkimit të provës i parashikuar nga nenet 208 deri më 220 të K.Pr. Penale.
- **Sekuestrimi si një masë sigurimi pasurore**, ku do të përfshihen sekuestroja konservative (nenet 270-273 te K. Pr. Penale) dhe sekuestroja preventive (nenet 274-276 te K.Pr.Penale)
- **Sekuestrimi si mase me karakter te perkoheshem** parashikuar nga "Ligji per Parandalimin dhe Goditjen e Krimit te Organizuar".

Instituti i sekuestrimit paraqitet në disa forma, në vartësi të qëllimit specifik që ndjek secili nga llojet e mësipërme të sekuestrimit.

Por te gjitha keto raste të sekuestrimit bashkohen ne një pike, që gjithmone është një masë që vendoset mbi sendet dhe **sjellin pamundësi e personit për ti gezuar dhe për ti disponuar keto sende.**

Kështu ika ndodhur edhe ne rastin konkret.Pavarësisht formës së shkresës drejtuar ZVRPP Sarandë ajo ka sjellë bllokimin e sendit dhe pamundësiën për ta gëzuar qetësisht atë.

Në rastin konkret duhet të fokusohemi në sekuestro si mjet për kërkimin e provës.

Sekuestrimi i disiplinuar në nenet 208-220

K.Pr.Penale eshte **nje mjet i kërkimit të provës** që shërben për marrjen dhe ruajtjen e provave materiale dhe apo të sendeve që lidhen me veprën penale kur ato janë të domosdoshme per vertetimin e fakteve. Ky sekuestrim vendoset nga Gjykata ose Prokurori te cilët duhet të disponojnë me vendim të arsyetuar:

"Gjyqtari ose prokurori disponojnë me **vendim të arsyetuar** sekuestrimin e provave materiale dhe të sendeve që lidhen me veprën penale kur ato janë të domosdoshme për vërtetimin e fakteve...."

Në këtë mënyrë Kodi .Pr.Penale i ka dhënë kompetencë që të disponojë ne lidhje me sekuestrimin si Gjykatës ashtu edhe Prokurorisë.

Kodi ka parashikuar edhe sekuestrimin e korrespondencës (neni 209) dhe sekuestrimin pranë bankave (neni 210) si dhe sekuestrimin në zyrën e mbrojtësit.

Ligji procedural penal ka parashikuar rregulla specifike për shkak edhe të karakterit të ndërhyrjes që përbëjnë këto masa në liritë dhe të drejtat kushtetuese të individit në një shoqëri demokratike.

Element dallues i sekuestrimit si mjet i kërkimit të provës, i quajtur ndryshe edhe sekuestroja penale, është se kjo masë vendoset vetëm ndaj provave materiale dhe sendeve që lidhen me veprën penale me qëllim të sigurojnë për procedimin penal të gjitha provat e mundëshme, apo materialet e dobishme për vërtetimin e kryerjes së veprës penale, pasojave të ardhura prej saj, fajësinë e të pandehurit apo shkallën e përgjegjësisë së tij.

Ky lloj sekuestrimi i përgjigjet nevojave të natyrës provuese që ka një procedim penal dhe për këtë arsye ky lloj sekuestrimi është disiplinuar në Kodin e Procedurës Penale së bashku me mjetet e tjera të kërkimit të provës, edhe këto kanë për qëllim marrjen e provave për të vërtetuar kryerjen e veprës penale, autoresinë e saj dhe shkallën e përgjegjësisë penale.

❖ Sekuestrimi si masë e sigurimit pasuror.

Masa e sekuestrimit mund të vendoset edhe mbi sende apo pasuri që nga ana e tyre këto mund të mos kenë lidhje me veprën penale apo që nuk janë të nevojshme për të provuar fakte apo rrethana që lidhen me veprën penale. Në këtë rast kemi dy lloje sekuestrimi të tilla si, sekuestroja konservative dhe sekuestroja preventive. Për sa i përket sekuestros konservative ajo vendoset ndaj pasurisë së luajtshme ose të paluajtshme të të pandehurit apo të shumëve ose sendeve që të tretët i detyrohen të pandehurit.

Me **sekuestro konservative** kuptohet heqja ose kufizimi i përkohëshëm i të drejtave pasurore mbi pasuri të luajtshme , me qëllim që të pengohen detyrimet që lindin si pasojë e veprës penale. Sekuestroja konservative vendoset me vendim të gjykatës në bazë të kërkesës së Prokurorit ose të paditësit civil në ato raste kur ka arsye të bazuara për të menduar se nuk ka garanci për pagimin e dënimeve me gjobë, shpenzimeve të procedimit dhe të çdo detyrimi ndaj pasurisë së shtetit.

Doktrina ka bërë dhe dallimin mes këture institutive duke sqaruar se :

Në qoftë se sekuestrimi si mjet i kërkimit të provës kishte si qëllim marrjen e provave dhe vërtetimin e veprës penale, sekuestroja konservative është një masë sigurimi që ka për qëllim të sigurojë në dobi të procesit penal një "konservim", të pasurisë së luajtshme ose të paluajtshme të të pandehurit apo të sendeve dhe të hollave që të tretët i detyrohen atij. Në mënyrë që kjo pasuri të mos transferohet, të fshihet apo të humbasë dhe të sigurohet pagimi i detyrimeve që mund të lindin si pasojë e veprës penale. Dhe për këtë

shkak është disiplinuar në Kodin e Procedurës së bashku me masat e tjera të sigurimit.

Ndërsa sekuestroja preventive është një masë sigurimi që vendoset mbi sende që lidhen me veprën penale dhe kur ekziston rreziku që disponimi i këtyre sendeve mund të rëndojë apo zgjasë pasojat e veprës penale ose të lehtësojë kryerjen e veprave penale të tjera. Është një masë që vendoset vetëm nga gjykata me kërkesë të prokurorit.

Objekt i sekuestros preventive mund të jenë sende që lidhen me veprën penale, çdo send tjetër që mund të sekuestrohet dhe kur këto sende nuk shërbejnë për realizimin e të provuarit të veprës penale. Sekuestroja preventive ka ndryshimet e veta nga sekuestroja penale (si mjet i kërkimit të provës). Ky ndryshim qëndron në raportin që lidhen me veprën penale konkrete.

Sekuestroja preventive nuk specifikohet në faktin e realizimit të të provuarit (marrjes së provës dhe vërtetimit të veprës penale), por ajo specifikohet në detyrimin që kërkon të evitojë rëndimin apo zgjatjen e pasojave të veprës penale apo lehtësimin e kryerjes së veprave të tjera penale.

Sekuestroja preventive mundet që të gjejë zbatim në ato raste kur nuk është vendosur sekuestrimi si mjet i kërkimit të provës, pra kur sendi është në disponim të lire, sepse nëse do të jete i sekuestruar atëherë nuk ekziston rreziku që të rëndohen apo zgjaten pasojat e veprës penale. Mos sekuestrimi i sendit si mjet i kërkimit të provës në një rast të tillë mund të ndodhe për mungesë të supozimeve se ky send mund ti shërbejë procesit të të provuarit, ose mund të vendoset kur në rastin konkret nevojat e të provuarit të veprës penale nuk përjashton objektivisht aplikimin edhe të sekuestros preventive

(kur nga ana fizike një send mund të lejojë një gjë të tillë, p.sh., kur ka vëllim të madh).

Pra, ndërsa sekuestroja penale i përgjigjet një nevoje të natyrës provuese , sekuestroja konservative dhe ajo preventive i përgjigjen realizimit të nevojave të sigurimit, për të siguruar pagimin e detyrimeve që mund të lindin nga vepra penale (sekuestroja konservative) dhe për të evituar rëndimin apo zgjatjen e e pasojave të veprës penale apo lehtësimin të veprave të tjera penale (sekuestroja preventive), dhe për këtë qëllim janë parashikuar bashkë me masat e sigurimit.

Sa më sipër u përshkuan mënyrat se si mund të sekuestrohet pasuria dhe rregullat proceduriale që duhet të ndiqen me qëllim që këto veprime të konsiderohen të ligjshme.

Argumentim

Shkresa e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë në vetvete është një veprim për sekuestrim të pasurisë së kërkuesit.

Kjo shkresë është një ndërthurje mes procedurës civile dhe asaj penale duke siguruar padinë në një proces penal.

Është e vërtetë që nga pikpamja formale nuk është një vendim dhe aq më pak I arsyetuar por efektet që ajo sjell janë si ato që sjell mjeti për kërkimin e provës së sekuestros.

Fakti që kjo shkresë nuk është vendim nuk mund të vendosë kërkuesin në pozita pamundësie për ta kundërshtuar atë.

Duke qënë se kjo shkresë është e pambështetur në asnjë dispozitë ligjore por bazohet në praktikën e organit të prokurorisë, kërkuesi ka të drejtë ta kundërshtojë atë dhe Gjykata të vendosë.

Nëse do të mbështeteshim në pretendimin se nuk ka bazë ligjore për ta kundërshtuar këtë shkresë atëhere do të lejonim që :

"një veprim I paligjshëm të marrë epërsi mbi parashikimet ligjore".

Qëllimi I ligjit ka qënë që të garantohen nevojat hetimore por të respektohen dhe të drejtat e të dëmtuarit apo të pandehurit gjatë këtij procesi.

Pretendimi I Prokurorisë se shkresa është thjesht një njoftim se pasuria mund të jetë fituar me dokumenta të fallsifikuara nuk është I mbështetur në prova.

Ky fakt konstatohet lehtësisht nga përmbajtja dhe mënyra e formulimit të shkresës me 3304 prot datë 05.05.2009 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Nëpërmjet kësaj shkrese ZRPP Sarandë I kërkohet të bllokojë cdo lloj transaksioni mbi pronën e kërkuesit. Vetë ZVRPP sarandë ne shkresë kthim përgjigje drejtuar kërkuesit është shprehur se është pikërisht shkresa e prokurorisë pengesa për kryerjen e veprimeve në lidhje me pronën.

Fakti që nga ana e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë nuk janë respektuar rregullat proceduriale bën që kjo shkresë apo veprim I Prokurorisë të jetë I pambështetur në ligj dhe për pasojë Gjykata në respektim të të drejtave të kërkuesit duhet të konstatojë shfuqizimin e shkresës me nr 3304 prot datë 05.05.2009 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Legjislacioni proceduarial penal ka parashikuar rregulla specifike për mënyrën se si mund të kufizohet pasuria sikurse është dhe seksuestro.

Këto rregulla specifike janë parashikuar në respektim të të drejtave të njeriut.

Nevojat për forma "moderne" të sekuestrimit në kuadrin e strategjive të luftës kundër krimit qëllimet që kanë këto masa, kanë një ndikim kufizues kundrejt të drejtës së pronës qe gezojne subjektet e së drejtës.

E drejta e pronës është sanksionuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, ku sipas saj :

“E drejta e pronës private është e garantuar”, “ligji mund të parashikojë shpronësimet ose kufizimeve në ushtrimin e të drejtës së pronës vetëm për interesa publike”, gjithashtu, në Kushtetutë sanksionohet “shpronësimet ose kufizimet e së drejtës së pronës që bazohen në shpronësimin, lejohen vetëm kundrejt një shpërblimi të drejtë”.

E drejta e pronës është sanksionuar edhe në nenin 1 të protokollit 1 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut. Sipas këtij neni,

“Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën për të gëzuar në mënyrë paqësore të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveç se për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara në ligj.....”

“Shtetet mund të nxjerrin ligjet që i konsiderojnë të domosdoshme për të rregulluar përdorimin e pasurisë në përputhje me interesin e përgjithshëm ose ...”

E drejta e pronës e sanksionuar si më sipër, nuk është një e drejtë e pakufizueshme, por një e drejtë që mund ti nënshtrohet “ndërrhyrjeve” të cilat për të qënë në përputhje me këtë të drejtë, duhet të justifikohen vetëm nëse “ndërrhyrja” është në interesin publik ose në dobi të një interesi të përgjithshëm.

Neni 1, protokollit 1, i Konventës me qëllim interpretimin sa më të qartë të tij ndahet në tre rregulla :

- I – **parimi i gëzimit në mënyrë paqësore**, që është fjalia e parë e paragrafit të parë të këtij neni;
- II – **privimi nga prona**, që është fjalia e dytë e paragrafit të parë të nenit 1;
- III – **kontrolli i përdorimit të pronës**, që është paragrafi i dytë i nenit 1 të protokollit 1.

Kushti që një marrje (ose privim) i pasurisë duhet të jetë në interesa publik “ parashikohet saktë në fjalinë e dytë të nenit 1 të protokollit, që quhet ndryshe “rregulli i dytë”.

Ndërsa “rregulli i tretë” i nenit 1 të protokollit 1 të Konventës i referohet shprehimisht “interesit të përgjithshëm”.

Pra, në çdo ndërrhyrje ndaj së drejtës së pronës, cilido rregulli që të gjejë zbatim duhet të përputhet me kushtin që ti shërbejë një **objektivi legjitim** që mund të jetë **interesi publik ose interesi të përgjithshëm**.

Gjykata e Strasburgut, në çështjet që janë bërë objekt shqyrtimi pranë saj, lidhur me të drejtën e pronës, parashikuar nga N. 1, prot. 1, i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, ka mbrojtur qëndrimin se “ masat

parandaluese pasurore nuk vijnë në kundërshtim me mbrojtjen që i bën Konventa të drejtës së pronës, por janë kufizime apo ndërhyrje të lejueshme nga Konventa.

Në rastin Raimondo kundër Italisë Gjykata e Strasburgut ka sqaruar ndërhyrjen në të drejtën e pronës :

Z. Raimondo iu drejtua Gjykatës së Strasburgut për të ankimuar masat e vendosura ndaj tij për 16 prona të paluajtshme dhe 6 mjete motorike, dhe gjithashtu edhe konfiskimin e disa aseteve të tjera. Kërkuesi iu drejtua gjykatës duke u mbështetur në N. 1, P.1 të Konventës.

Nuk u mohua as nga shteti në këtë rast që të ketë patur ndërhyrje në të drejtën e pronës. Sipas gjykatës, masa e sekuestrimit në këtë rast, ishte një masë provizore që kishte si qëllim të siguronte, që prona që dyshohej se ishte produkt i aktiviteteve të paligjëshme, të qëndronte në atë gjëndje që ishte deri në marrjen e një vendimi perfundimtar lidhur me këtë pasuri dhe të mos qëndronte larg vëmëndjes së shtetit. Sepse këto pasuri ishin të dyshuara si produkt i aktiviteteve të paligjëshme dhe për këtë shkak komuniteti mund ti konfiskonte në qoftë se ishte e nevojshme.

Në këtë kontekst, mund të themi se sekuestrimi duhet të përbëje masë pasurore parandaluese që megjithëse përfaqësojnë një ndërhyrje në të drejtën e pronës për nga qëllimi legjitim (interesi i përgjithshëm) që ato ndjekin dhe të përbëjnë një ndërhyrje propocionale dhe të pranueshme në një shoqëri demokratike të së drejtës së pronës, në përputhje me standartin kushtetues dhe atë ndërkombëtar.

- Në këtë gjykim vlerësohet se jemi përpara shqyrtimit të parimit të parë dhe të tretë të mbrojtur nga ana nenit 1 të protokollit 1 të KEDNJ:

parimi i gëzimit në mënyrë paqësore, që është fjalia e parë e paragrafit të parë të këtij neni;

III – kontrolli i përdorimit të pronës, që është paragrafi i dytë i nenit të protokollit 1.

Kufizimi në të drejtën e pronës të caktuar me vendimin e sekuestrimit në këtë rast **është I pa ligjshëm** pasi nuk janë respektuar rregullat procedurale të parashikuara në ligjin procedural penal.

Kjo bën që të arrihet në konkluzionin se nga ana e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë është cënuar në mënyrë të paligjshme pasuria e Tefik Ismaili.

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë I ka patur të gjitha mundësitë që të kufizojë pasurinë e Tefik Ismaili duke respektuar procedurat ligjore.

Kjo shkresë është pasqyrim i nje veprimi te paligjshem dhe si i tille nuk duhet te jape asnje efekt.

përfundimisht Gjykata çmoi se shkresa me nr 3304 prot date 05.05.2009 e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë është e pambështetur në ligj dhe si e tillë duhet të shfuqizohet.

PËR KËTO ARSYE

Në bazë të neneve 291, 292 të K.Pr.Penale

VENDOSI

1. Pranimin e kërkesës penale me nr 117 Akti të shtetasit [REDACTED]
2. Shfuqizimin e shkreses me nr 3304 prot datë 05.05.2009 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë drejtuar ZVRPP Sarande.
3. Shpenzimet gjyqësore sic janë kryer.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankim brenda 10 ditëve në Gjykatën e Apelit Vlorë.

U shpall në Vlorë sot, më datë 12.03.2010 !
SEKRETARE

MARJANELA BESHTIKA



GJYQTARE

ELVANA ÇIÇOLLI

